



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Imagjinoni, me ne...

E gjallëruar, plotë jetë Qendra e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës: një qendër ku gratë nga të gjitha lokalitetet e Kosovës do të mbledhen për bashkëbisedim, bashkëpunim, krijimin e strategjive dhe avokim për të drejtat e grave.

Paramendoni një dhomë të madhe ku gratë do të organizojnë evente, transmetojnë artin, shfaqin filma, ekspozojnë fotografi, botojnë publikime, takojnë vendim-marrësit, duke mos paguar më hotele sepse hapësira është PA PAGESË.

Imagjinoni një kafene që shërben kafe apo çaj, pije të ftohta, dhe ushqime tradicionale, të përgatitura nga gratë. Në muret e kësaj shtëpie janë vendosur libra mbi barazinë gjinore. Mbi tavolina janë blloqet të mbushura me debate. Poetët recitojnë, të rinjtë marrin pjesë në debate të hapura, dhe autorë të famshëm ndërkombëtar flasin me studentët dhe aktivistët e Prishtinës.

Paramendoni një dhomë ngjitur ku janë vendosur produktet tradicionale në dru dhe veshjet e qëndisura nga duart e grave janë ekspozuar për shitje. Bodrumi është i tejmbushur me produkte që gratë me vullnet i kanë përgatitur për eksport në SHBA dhe BE, duke përfshirë kulturën Kosovare jashtë vendit dhe duke fuqizuar gruan Kosovare e cila tani mund të fitojë përmes punës nga shtëpia.

Imagjinoni lartë: dhoma e takimeve për anëtarët e RrGGK, një qendër për trajnime dhe zyret e stafit të RrGGK të cilat punojnë me përkushtim, siç kanë punuar për 13 vite, drejt realizimit të të drejtave të grave: për një jetë pa dhunë, përmirësimin e shëndetësisë, fuqizimin ekonomik të gruas, dhe avancimin e mëtejshëm të pjesëmarrjes së grave në vendim-marrje.

Imagjinoni një mozaik në murin kryesor të Qendrës së Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës: pllaka të vendosura me kujdes ku secila prej tyre paraqet një mbështetës të RrGGK, dhe të drejtave të grave. Së bashku ata formojnë një rrjet...

Imagjinoni aty është edhe emri juaj.

Mbështetni organizatat e grave.

Mbështetni të drejtat e grave.

Mbështetni RrGGK-në.

Fakte të shpejta

- o **RrGGK**: rrjet multi-etnik i përbërë nga 100 organizata të grave nga gjitha lokalitetet e Kosovës
- o Zëri udhëheqës për gratë dhe vajzat në Kosovë; i mirënjohur dhe i respektuar në nivelet rajonale dhe ndërkombëtare
- o Një qeverisje transparente dhe e përgjegjshme dhe struktura të menaxhimit financiar, nën mbikëqyrjen e një Bordi aktiv dhe organizatave anëtare të RrGGK
- o **€2,000** në llogarinë tonë të kursimeve afat-gjata
- o **79m²** hapësirë për momentin, me 8+ staf brenda saj
- o **€12,000** të shpenzuara në vit për qeran e hapësirës, të cilat ne do të preferonim t'ua kushtojmë në mënyrë direkte avancimit të mëtejshëm të të drejtave të grave... Vetëm sikur të kishim hapësirën tonë.

RrGGK: 13 Vitet e Aktivizmit

- o Ka ndihmuar në ndryshimin e ligjeve qenësore dhe politikave që gratë të përfitojnë duke përfshirë ligjin për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje
- o Ka udhëhequr përpjekjet për të kërkuar drejtësi për krime e luftës në Kosovë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar
- o Ka krijuar Fondin e Grave të Kosovës, duke mbështetur komunitetin dhe grupet e marginalizuara të cilat kanë mungesë të qasjes në fonde
- o Ka themeluar Koalicionin e Strehimoreve për gratë dhe fëmijët që vuajnë nga dhuna i cili ka ndihmuar qindra gra dhe fëmijë në Kosovë
- o Ka mundësuar analizat diagnostifikuese për kancerin e gjirit dhe osteoporozën për gratë në zonat urbane dhe rurale
- o Ka inspiruar veprime shtetërore për të mbrojtur mijëra gra që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës
- o Ka themeluar Grupet për Barazi Gjinore dhe Avokim në tetë komuna që bashkojnë gratë politkane dhe aktiviste për adresimin e shqetësimeve të grave, përfshirë edhe transportin publik për vajzat që të ndjekin shkollën dhe gratë të kenë qasje në punë
- o Ka avokuar në përfshirjen e grave në negociatat për statusin politik të Kosovës
- o Ka fuqizuar dhjetëra gra politkane që të punojnë në çështjet e rëndësishme për gratë
- o Ka mentoruar qindra aktiviste në strategji të suksesshme për rrjetëzim dhe avokim në mënyrë që të përfitojnë komunitetet e tyre

Bëhuni pjesë e rrjetit dhe ëndrrës tonë!

Ju mund të dhuroni donacione me tatim të zbritur përmes partnerëve tanë në East - West Management Institute. Përshkruani në vijën për shënim që donacioni është për RrGGK (ne do të pranojmë 100% të të gjitha donacioneve). Dërgoni çekun në:

East-West Management Institute, Inc.
Attn: Naomi Hansen
575 Madison Ave., 25th Floor
New York, NY 10022

Përveç kësaj, ju mund të përdorni kredit kartën tuaj për të dhuruar donacione [online](#) duke e dërguar për "RrGGK"